



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**MBI KONKURRIMIN NDËRKOMBËTAR TË SHOQATËS GJEOGRAFIKE RUSE
PËR VITIN 2016**

Shoqata Ndërkombëtare Gjeografike Ruse, në datën 1 korrik 2016, ka shpallur procedurat e aplikimit për pranimin e kërkesave për Çmimin Ndërkombëtar të Shoqërisë Gjeografike Ruse të vitit 2016. Çmimi i Shoqatës Gjeografike Ruse është dekoratë prestigjioze e nivelit ndërkombëtar.

Konkurrimi për çmimin ndërkombëtar, i cili është organizuar për here të parë në vitin 2014, ka një status ndërkombëtar dhe mbahet një herë në dy vjet. Çmimi i Shoqatës Gjeografike Ruse u jepet individëve/ ose organizatave ndërkombëtare të çdo vendi të botës, të cilët aplikojnë në fushën e gjeografisë kombëtare, ekologjisë, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore të Rusisë.

Finalistët e Çmimit do të shpallen nga Juria e Shoqatës Gjeografike Ruse. Organizatorët rusë janë të interesuar për rezultate konkrete të projekteve të ndryshme në fushat e mësipërme, ku përfshihet edhe fusha e kinematografisë për filmat e njohur shkencorë që janë realizuar, duke zbuluar botën e shkencës dhe gjeografisë.

Për detaje të tjera lidhur me materialet informativë, afatet dhe mënyrën e aplikimit *on line*, referojuni adresave të internetit:

www.rgo.ru;

<https://www.rgo.ru/en/form/application-form-award-russian-geographical-society>.

Afati i fundit për aplikimin online është data 30 shtator 2016. Ceremonia për shpalljen e fituesve do të mbahet në fund të vitit. Detaje të tjera për vendin dhe datën e ceremonisë do të publikohen nga Shoqata Ndërkombëtare Gjeografike Ruse.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE